



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**STRUKTURA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TE
ORGANIZUAR
DREJTORIA E BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR**



**RAPORTI I MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË BUXHETIT
viti 2023**

Shkurt 2024

KUADRI LIGJOR RREGULLATOR

1. LIGJI 95/2016 “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E INSTITUCIONEVE PËR TË LUFTUAR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR”, I NDRYSHUAR.
2. LIGJI 96/2016 “PËR STATUSIN E GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”
3. LIGJI NR. 9936, DATË 26.06.2008 “PËR MENAXHIMIN E SISTEMIT BUXHETOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR.
4. LIGJI 10296, DATË 08.07.2010 “PËR MENAXHIMIN FINANCIAR DHE KONTROLLIN” (I NDRYSHUAR),
5. UDHËZIMIT NR.22, DATË 17.11.2016 “PËR PROCEDURAT STANDARTE TË MONITORIMIT TË BUXHETIT PËR NJËSITË E QEVERISJES QËNDRORE”
6. UDHËZIMI I MINISTRIIT TË FINANCËVE DHE EKONOMISË NR.9, DATË 20.03.2018 “PËR PROCEDURAT STANDARTE TË ZBATIMIT TË BUXHETIT”
7. LIGJI NR.162/2020 “PËR PROKURIMET PUBLIKE”,
8. VKM 285/2021 “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK I NDRYSHUAR”
9. LIGJI NR.84/2022 “PËR BUXHETIN E VITIT 2023”,
10. UDHËZIMIT NR. 2, DATË 19.01.2023 “PËR ZBATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2023”,
11. UDHËZIMIT NR.14, DATË 30.05.2023 “PËR PROCEDURAT STANDARTE TË MONITORIMIT TË BUXHETIT PËR NJËSITË E QEVERISJES QËNDRORE”
12. VKM NR.437, DATË 19.07.2023 “PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E MIRATUAR PËR VITIN 2023 PËR DISA INSTITUCIONE TË PAVARURA”
13. VKM NR.755, DATË 20.12.2023 “PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E MIRATUAR PËR VITIN 2023 PËR DISA INSTITUCIONE TË PAVARURA”
14. AKTIT NORMATIV NR. 5, DATË 18.10.2023, “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN 84/2022 “PËR BUXHETIN E VITIT 2023”
15. AKTIT NORMATIV NR. 6, DATË 04.12.2023 “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN 84/2022 “PËR BUXHETIN E VITIT 2023”

TABELA E PERMBAJTJES

- 1 HYRJE*
- 2 INFORMACIONI BUXHETOR I AGREGUAR*
- 3 PERFORMANCA E TREGUESVE KYÇ TË PERFORMANCËS ME BAZË GJINORE, NË
NIVEL PRODUKTI*
- 4 PERFORMANCA E BUXHETIT NË NIVELIN E PROGRAMIT*
 - 4.1.PERFORMANCA FINANCIARE E PROGRAMT BUXHETOR*
 - 4.2.PERFORMANCA JO-FINANCIARE E PROGRAMIT BUXHETOR*
 - 4.3.VEPRIMET VIJUESE NË NIVELIN E PROGRAMIT BUXHETOR*
- 5 PROJEKTET KAPITALE*
- 6 NDRYSHIMET NË BUXHET*
- 7 PËRFUNDIME*

1 HYRJJE

Monitorimi i zbatimit të buxhetit gjatë vitit 2023 për Strukturën e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar përfaqëson procesin e vlerësimit të performancës së fondeve buxhetore, nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë të performancës me ato të planifikuar. Strukturat e SPAK-ut kanë kryer monitorimin e treguesve buxhetorë me qëllim ndjekjen në vijimësi të objektivave të synuar në përputhje me planin strategjik të ecurisë së institucionit dhe të gjitha kërkesave ligjore. Nëpërmjet këtij raporti monitorimi, evidentohet niveli i realizimit të fondeve buxhetore të SPAK-ut në krahasim me planin e miratuar, të detajuar në nivel treguesi performance. Analiza e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit vjetor i mundëson institucionit orientimin dhe sigurimin e një informacioni shtesë për të përmirësuar procesin e planifikimit dhe të menaxhimit të buxhetit. Ky raport zyrtar do të shërbejë si një pasqyrë e rëndësishme përmes së cilës SPAK do të synojë lidhjen e kostove buxhetore me produktet e performancës, si forma më e mirë e buxhetimit dhe vlerësimit financiar të ecurisë së institucionit.

2 INFORMACIONI BUXHETOR I AGREGUAR

Buxheti i Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për vitin 2023 është miratuar me ligjin nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023” i ndryshuar, ku në total rezulton të jetë planifikuar një vlerë prej 1,178 milionë lekë dhe me buxhetin vjetor të rishikuar në vlerën 1,077.4. Gjatë vitit 2023, këto burime financiare SPAK si një institucion kushtetues, i ka përdorur në funksion të përmbushjes së plotë të detyrimeve të miratuara me ligj. Fondet buxhetore të miratuara përmes ligjit vjetor të buxhetit, SPAK i ka administruar për financimin e aktiviteteve në një program të përcaktuar me emertimin “Veprimtaria e SPAK”.

Totali i Shpenzimeve të Institucionit për vitin 2023

(000/lekë)

Titulli	Emertimi	Plani Fillestar Vjetor	Plani Vjetor i Rishikuar	Shpenzime Faktike	Diferenca	% e realizimit fakt/plan
1	2	3	4	5	6=(5-4)	7=(5/4)
03390	Veprimtaria e SPAK	1,178,000	1,077,438	1,042,742	34,696	97%
Totali i Shpenzimeve të Institucionit		1,178,000	1,077,438	1,042,742	34,696	97%

Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar

Me miratimin e detajimit të fondeve buxhetore të shpërndara për Prokurorinë e Posaçme dhe BKH-në, gjatë vitit 2023 është vijuar me marrjen e angazhimeve dhe kryerjen e pagesave bazuar në dokumentacionin justifikues të shpenzimeve, brenda limiteve dhe në afatet e përcaktuara. Realizimi në total i shpenzimeve është rreth 1,042.7 milion lekë ose rreth 97% të buxhetit vjetor të rishikuar.

Tabela 1: Raporti përmbledhës i shpenzimeve

(000/lekë)

Art.	Emertimi	Plani Fillestar Vjetor	Struktura e shpenzimeve	Plani Vjetor i Rishikuar	Struktura e shpenzimeve	Shpenzime Faktike	Struktura e shpenzimeve
1	2	3		4		5	
600	Paga	782,509.0	66%	831,162.0	77%	824,797.0	79%
601	Sigurime Shoqërore	200,374.0	17%	60,174.0	6%	60,004.0	6%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	128,117.0	11%	163,617.0	15%	149,084.0	14%
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ			484.0	0%	419.0	0%
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	1,111,000.0	94%	1,055,437.0	98%	1,034,304.0	99%
231	Kapitale të Trupëzuara	67,000.0	6%	22,000.0	2%	8,435.0	1%
Nen-Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	67,000.0	6%	22,000.0	2%	8,435.0	1%
Totali (korrente + kapitale)		1,178,000.0	100%	1,077,437.0	100%	1,042,739.0	100%

Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar

Duke u mbështetur në veprimtarinë bazë të institucionit, pjesë përbërës e të cilit janë:

1. Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar me kod institucioni në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë 1041001,
2. Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH) me kod institucioni në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë 1041002,

gjatë vitit 2023, ka vijuar puna duke synuar në konsolidimin financiar dhe administrativ të institucionit, me qëllim arritjen e objektivave për realizimin e treguesve buxhetor dhe treguesve të performancës të përcaktuar në programin buxhetor afatmesëm 2023-2025




Figure 1 Pesha sipas llogarive ekonomike të planit të buxhetit viti 2023

Në analizë të informacionit të paraqitur në mënyrë tabelare dhe grafiksht, rezulton se:

- a) Sipas planit fillestar të miratuar, shpenzimet korrente zënë një peshë specifike 94% në vlerë rreth 782.5 milion lekë, ndërsa shpenzimet për investime zënë një peshë specifike 6% , në vlerë rreth 67 milion lekë.

- b) Sipas planit të rishikuar, shpenzimet korrente zënë një peshë specifike 98% në vlerë rreth 831.1 milion lekë, ndërsa shpenzimet për investime zënë një peshë specifike 2% , në vlerë rreth 22 milion lekë.
- c) Sipas realizimit faktik, në totalin e shpenzimeve të realizuara shpenzimet korrente zënë 99% në vlerë 827.7 milion lekë, ndërsa shpenzimet kapitale 1% në vlerë 8.4 milion lekë.

Bazuar mbi parimin e vijueshmërisë së aktivitetit të institucionit, me qëllim marrjen e masave për identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të institucionit, në vijim paraqesim analizën krahasuese të realizimit të treguesëve buxhetorë me vitin paraardhës.

Raporti i shpenzimeve të realizuara, viti 2022 dhe viti 2023

(000/lekë)

Programi		Veprimtaria e SPAK					
Zërat e shpenzimeve		Viti paraardhës 2022		Viti Ushtrimor 2023		Diferenca (2023/2022)	% Realizimi (2023/2022)
		Shpenzime faktike	Struktura e shpenzimeve në %	Shpenzime Faktike	Struktura e shpenzimeve në %		
1	2	3	4 =(zëri i shpenz/total)	5	6 =(zëri i shpenz/total)	7=(5-3)	8=(5/3)
600	Paga	429,825.6	73%	824,797.0	79%	394,971	92%
601	Sigurime Shoqërore	38,006.1	6%	60,004.0	6%	21,998	58%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	99,042.2	17%	149,084.0	14%	50,042	51%
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	1,838.9	0%	419.0	0%	- 1,420	-77%
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	568,712.8	97%	1,034,304.0	99%	465,591	82%
231	Kapitale të Trupëzuara	19,350.4	3%	8,435.0	1%	- 10,915	-56%
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	19,350.4	3%	8,435.0	1%	- 10,915	-56%
Totali		588,063.2	100%	1,042,739.0	100%	454,676	77%

Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar




Figure 2 Pesha sipas llogarive ekonomike të realizimit faktik për vitet 2022 dhe 2023

1.Në mënyrë tabelare dhe grafikisht paraqitet struktura e shpenzimeve për vitin paraardhës dhe periudhën raportuese. Rritja shpenzimeve për paga, mallra e shërbime, vjen për shkak, të

ndryshimeve ligjore gjatë vitit 2023 lidhur me ndryshimet e pagave, shtimit të kapaciteteve të burimeve njerëzore të cilat janë drejt konsolidimit të plotë, sigurimit të një infrastrukture të përparuar së teknologjisë së informacionit, shtimin e nevojave të mirëmbajtjes së paisjeve informatike dhe licensave përkatëse të nevojshme për strukturat e posaçme hetimore të SPAK. Krahasuar me periudhën e mëparshme të raportimit (viti 2022), shpenzimet buxhetore të realizuara për vitin 2023, janë rreth 454 milion më të larta (1,042 milion lekë viti 2023/588 milion lekë viti 2022). Nga të cilat, shpenzimet për paga dhe sigurime janë rreth 416.8 milion lekë më shumë. Konstatohet se në zërin e shpenzimeve për investime ka një realizim më të ulët krahasuar me vitin paraardhës rreth 50% në vlerë 10.9 milion lekë.

2.Gjatë vitit 2023 nga SPAK janë ndërmarrë veprime korrigjuese nëpërmjet ndryshimit të alokimit të burimeve duke evidentuar njëkohësisht impaktin në performancën e objektivave:

a)Me shkresën Nr. 6160 prot., datë 28.04.2023, miratuar nga MFE me shkresën Nr.8074/1prot., datë 16.05.2023, është kërkuar rishpërndarja e shpenzimeve (nga 601 në 602) në shumën 60 milionë lekë, kërkesë e cila ka qënë bazuar në kërkesat e shtuara të cilat lidhen me shpenzimet për mirëmbajtjen e sistemeve të teknologjisë si sistemi i bërthamës komanduese ai i ekspertizës dhe i IT, kërkesa të cilat janë referuar dhe në PBA 2023-2025.

b)Me shkresën 8872, datë 21.06.2023 është miratuar riallokimi i fondit 1.24 milionë lekë shpenzime për paga (nga Prokuroria kaluar BKH-së) për të mbuluar efektet nga zbatimi i VKM 325/2023.

c) Për zbatimin e Vendimeve Gjyqësore, lidhur me ankimet e paraqitura nga Magjistratët për rivlerësimin e pagës bazë referuese, Prokuroria e Posaçme ka paraqitur kërkesë për riallokim nga zëri shpenzime operative dhe shpenzime për sigurime në total në shumën 11 milion lekë, miratuar nga MFE me shkresën Nr.15129/2 datë 15.11.2023. Dhe me shkresën në. 15129/1 prot., datë 15.11.2023, është miratuar riallokimi i shpenzimeve për paga, nga BKH tek Prokuroria e Posaçme, në shumën 5 milion lekë.

d) Me shkresën 13162 prot., datë 06.10.2023, drejtuar Ministrit të Financave dhe Ekonomisë është paraqitur kërkesa për riallokim të fondeve për investimeve, kërkesë e miratuar me shkresën nr.18464 prot., datë 10.10.2023, shtesat dhe pakësimet sipas produkteve janë trajtuar më poshte.

3.Për sa i përket numrit të punonjësve me ligjin nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, për SPAK struktura e miratuar është për 271 persona, nga të cilët 133 persona Prokuroria e Posaçme dhe 138 persona Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH). Efektiv deri në fund të periudhës raportuese janë 178 persona nga të cilët 105 persona në Prokurorinë e Posaçme dhe 73 persona në BKH. Gjatë vitit 2024 të dy institucionet do të vijojnë procedurat për plotësimin e strukturave.

3 *PERFORMANCA E TREGUESVE KYÇ TË PERFORMANCËS ME BAZË GJINORE, NË NIVEL PRODUKTI*

Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar,bazuar në orjentimet e MFE me shkresën Nr.1087prot., datë 18.01.2024, në kuadër të PBA 2024-2026 faza përfundimtare, ka parashikuar tregues performance me bazë gjinore në nivel produkti. Treguesi i parashikuar është: %

e grave në poste drejtuese të institucionit ndaj totalit të posteve drejtuese, baseline për vitin 2023 është 39% .

4 PERFORMANCA E BUXHETIT NË NIVELIN E PROGRAMIT

4.1.PERFORMANCA FINANCIARE E PROGRAMT BUXHETOR

Qëndrueshmëria financiare e institucionit dhe ndjekja me rigorozitet e procedurave të menaxhimit financiar publik, kanë udhëhequr veprimtarinë administrative të SPAK. Realizimi i shpenzimeve sipas zërave për vitin 2023, krahasuar me planin e rishkuar në programin buxhetor “Veprimtaria e SPAK”, paraqitet në pasqyrën e mëposhtme:

Raporti i Shpenzimeve të programit

(000/lekë)

Art.	Emertimi	Plani Fillestar Vjetor	Plani Vjetor i Rishikuar	Shpenzime Faktike	Ndryshimi vjetor (Plan-Fakt)	Struktura e realizimit të shpenzimeve ne %
1	2	3	4	5	6=(4-5)	7=(5/4)
600	Paga	782,509.0	831,162.0	824,797.0	6,365.0	99%
601	Sigurime Shoqërore	200,374.0	60,174.0	60,004.0	170.0	100%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	128,117.0	163,617.0	149,084.0	14,533.0	91%
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ		484.0	419.0	65.0	87%
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	1,111,000.0	1,055,437.0	1,034,304.0	21,133.0	98%
231	Kapitale të Trupëzuara	67,000.0	22,000.0	8,435.0	13,565.0	38%
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	67,000.0	22,000.0	8,435.0	13,565.0	38%
Totali (korrente + kapitale)		1,178,000.0	1,077,437.0	1,042,739.0	34,698.0	97%

Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar




Figure 3: Peshat specifike të realizimit të shpenzimeve sipas zërave buxhetor

1. Për sa i përket realizimit faktik krahasuar me buxhetin vjetor të miratuar rezultojnë se përqindja e realizimit sipas zërave buxhetorë paraqitet: shpenzime për paga rreth 99%, shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera rreth 91% , shpenzime për sigurime rreth 100% si dhe shpenzimet për investime 38%

2.**Shpenzime për Paga** Realizimi faktik i shpenzimeve për paga është në shumën 824.7 milion lekë nga të cilat, për Prokurorinë e Posaçme në shumën 391.9 milion lekë dhe për BKH-në në shumën 432.9 milion lekë. Bëjmë me dije gjithashtu se pjesë e shpenzimeve për paga, gjatë vitit 2023 janë

edhe pagesat e kryera mbi kohën shtesë të punës, për kategorinë e subjekteve magjistratë dhe jomagjistratë. Në total janë paguar rreth 45.8 milion lekë nga të cilat Prokuroria e Posaçme 16.2 milion lekë, ndersa BKH 29.6 milion lekë. SPAK ka likujduar të gjitha detyrimet rrjedhojë e efekteve të Vendimit të GJK 35/2022, në total rreth 140.8 milion lekë, nga të cilat Prokuroria e Posaçme rreth 72.2 milion lekë dhe BKH në shumën 68.6 milion lekë.

3.Shpenzime për Mallra dhe Shërbime

Shpenzimet e kryera për të cilat janë përdorur fondet e planifikuara i referohen kryesisht shpenzimeve nga realizimi i kontratave 2-vjecare, Marrëveshjet Kuadër nga viti 2022, detyrimeve kontraktuale bazuar në procedurat e prokurimit të realizuara gjatë vitit 2023, shpenzime utilitare, shpenzime ekspertiza, shërbime kadastrale, udhëtime-dieta etj. Sa trajtuar dhe më lartë për të përmbushur detyrimet kontraktuale lidhur me kontratat 2- vjecare (shpenzime të mirëmbajtjes së sistemeve të bërthamës elektronike dhe IT, shpenzime të shtuara për vitin 2023, krahasuar me vitin 2022 në shumën 35 milionë lekë si dhe realizimin e procedurës së prokurimit “Shërbim për rinovimin e licencave për mirëmbajtjen e pajisjeve të Sektorit të Ekspertizës” parashikuar fillimisht në shumën 26 milionë lekë është kërkuar rialokimi i fondeve në total në shumën 60 milion, kërkesë e cila është miratuar nga MFE.

Gjithashtu gjatë vitit 2023 janë reflektuar ndryshimet në Regjistrin e parashikimit të procedurave të prokurimit, (njoftuar Degën e Thesarit rast pas rasti). Për plotësimin e nevojave të institucionit për mallra dhe shërbime, nëpërmjet procedurave të prokurimit të realizuara gjatë ushtrimit, zbatimit të kontratave 2 vjeçare si dhe minikontratave të lidhura nga Marrëveshjet Kuadër të vitit 2022, gjatë vitit 2023 janë realizuar shpenzime në shumën 103.6 milion lekë. Rreth 70 milion lekë ose 67.5%(70/103.6) e tyre zënë shpenzimet për mirëmbajtjen e sistemeve të teknologjisë (30 milionë shpenzime mirëmbajtje bërthama komanduese, 20.1 milionë shpenzime mirëmbajtje sisteme të IT, 18 milion shpenzime rinovim programe të sektorit të ekspertizës si dhe 2.3 milion lekë shpenzime mirëmbajtje motorola. Rreth 45 milion lekë në totalin e shpenzimeve operative janë shpenzimet utilitare dhe shpenzime procedurale. Bëjmë me dije gjithashtu se gjatë vitit 2023 nga Eurojust Prokuroria e Posaçme ka marrë rimbursim rreth 5 milion lekë për shpenzime procedurale lidhur me shërbime përkthimi.

4.Me ligjin nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, fillimisht janë planifikuar për tu realizuar në formën e investimeve vlera prej 67milion lekë për blerje të produkteve: a)pajisje zyre në vlerën 35 milion lekë, b)blerje pajisje elektronike në shumën 5 milion lekë, c)skaner për kontrollin e automjeteve në shumën 11 milion lekë, d)blerje automjete në shumën 10 milion lekë dhe e)blerje pajisje operationale në shumën 6 milion lekë.

Në përfundim të ushtrimit realizimi i Investimeve me Financim të Brendshëm për vitin 2023 sipas zërave paraqitet në total në shumën 8.4 milion lekë nga të cilat:

- | | |
|-----------------------|------------------|
| • Blerje automjete | 7.95 milion lekë |
| • Blerje Pajisje zyre | 0.48milion lekë |

Për sa i përket mosrealizimeve sipas produkteve në investime kapitale, më poshtë do të trajtojmë arsyet si dhe procedurën e ndjekur nga SPAK lidhur me rialokimin e fondeve si dhe deklarin si teprica buxhetore:

-Produkti, pajisje zyre (produkt i cili ishte parashikuar për mobilimin e godinës së re e cila pritej të kalonte në administrim të SPAK), në kushtet e nevojës për kryerjen fillimisht të punimeve për përshtatjen e ambjenteve të brendshme, nuk u inicua procedura e prokurimit për blerjen e tyre.

-Produkti, skaner për dedektimin e automjeteve, fondi limit rezultuar nga studimi i tregut, rezultoi ndjeshëm në një vlerë më të lartë se sa buxheti i miratuar për realizimin e këtij produkti.

-Produkti pajisje operationale, fondi limit nga studimi i tregut ka rezultuar në një vlerë më të lartë se sa buxheti i miratuar për këtë zë investimi.

Në vijim, me qëllim mirëmenaxhimit të fondeve buxhetore, për fondet e parashikuara fillimisht, për mobilje zyre, për skaner të dedektimit të automjeteve dhe të pajisje operationale, u gjykua përdorimi i tyre për realizimin e investimeve në fushën e elektronikës, për blerje pajisje dhe sisteme elektronike si dhe realizimin e investimit për ndërtimin e një muri rrethues për Godinën e re të kaluar në administrim të SPAK. Me shkresën 13162 prot., datë 06.10.2023, drejtuar Ministrit të Financave dhe Ekonomisë është paraqitur kërkesa për rialokim të fondeve për investimeve, kërkesë e miratuar me shkresën nr.18464 prot., datë 10.10.2023. Shtuar produkti pajisje elektronike në shumën 49 milion lekë si dhe ndërtim muri rrethues në shumën 4 milion lekë, duke pakësuar produktet: blerje pajisje zyre në shumën 34 milion lekë, skaner për dedektimin e automjeteve në shumën 11 milion lekë, produkti pajisje operationale në shumën 6 milion lekë dhe blerje automjete në shumën 2 milion lekë.

-Për shkak të vonesave në miratimin e lejes së ndërtimit, projekt i parealizuar për vitin 2023, ka rezultuar dhe ndërtimi i murit rrethues për godinën e re të kaluar gjatë vitit 2023 në administrim të SPAK.

- Gjithashtu lidhur me procedurën blerje pajisje elektronike, parashikuar për tu realizuar me disa lote, duke angazhuar nga fondet buxhetore në total në shumën 54 milion lekë (me TVSH) në pamundësi të përfundimit me sukses të një prej loteve, për të cilin ishin angazhur fonde nga buxheti i shtetit, Prokuroria e Posaçme mori masat për deklarimin pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si teprica në zërin e Investimeve për shumën 45 milion lekë.

Për plotësimin e nevojave të institucionit me mallra dhe shërbime si dhe investime gjatë vitit 2023, janë iniciuar 50 procedura prokurimi si dhe janë lidhur 46 kontrata/minikontrata me operatorët ekonomikë.

5.Gjatë vitit buxhetor 2023, për SPAK është planifikuar si Fond i Veçantë (Llogaria 606) për mbulimin e rasteve të fatkeqësive në shumën 0.48 milion lekë. Për vitin 2023 fondi i përdorur është në vlerën 0.42 milion lekë.

6.SPAK në kuadër të eficientës së përdorimit të burimeve publike vetem nga kërkesat për materiale proceduriale si dhe të ardhura nga gjobat gjyqësore, ka arkëtuar në buxhetin e shtetit rreth 2.9 milion

lekë. Gjatë vitit 2023, Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, ka likuiduar me korrektesë të gjitha detyrimet të krijuara nga aktiviteti ndaj palëve të treta.

4.2.PERFORMANCA JO-FINANCIARE E PROGRAMIT BUXHETOR

Realizimi i produkteve buxhetore në nivel performance për Strukturën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për vitin vitin 2023 paraqiten si më poshtë:

Treguesit e performancës/Produktet:						Sqarime
Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit	Niveli faktik i vitit 2022	Niveli i planifikuar ne vitin 2023	Niveli i rishikuar ne vitin 2023	Niveli faktik viti 2023	% e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit	
Raporti midis numrit të çështjeve të përfunduara(hetuara) kundrejt atyre të regjistruara(nën hetim).	30%	80%	50%	27.3%	55%	Për vitin 2023, çështje nën hetim, 708 (regjistruar gjatë vitit 299 procedime penale +449 të mbartura, - 42 procedime të bashkuara). Të zgjidhura nr 193 (53 per gjykim+29 pushim +87 transferuar per kompetence+24 pezulluar)
Raporti midis numrit të çështjeve të dërguara për gjykim kundrejt atyre të përfunduara(hetuara).	29%	70%	35%	27.4%	78%	Për vitin 2023 janë dërguar në gjykatë me kërkesë për gjykim 53 procedime penale nga 193 te zgjidhura
Raporti midis numrit të personave të hetuar kundrejt atyre të regjistruar(nën hetim).	57%	65%	60%	63%	105%	Për vitin 2023 ka përfunduar hetimi për 364 persona nga 575 persona nën hetim

Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar




Figure 2: Realizimi i treguesëve për periudhën paraardhëse dhe atë raportuese

Për sa konstatohet më lart në tabelën e paraqitur produktet buxhetore të planifikuara në programin “Veprimtaria e SPAK” kanë një nivel realizimi të kënaqshëm, në kushtet e argumenteve si më poshtë vijon:

1.Lidhur me produktin 94101AB Dosje të përfunduara, është dhënë informacioni mbi mënyrën e llogaritjes për çdo tregues të performancës. Nëse i referohemi çështjeve të zgjidhura për vitin 2023, 193 çështje, me ato të regjistruara për gjatë vitit 2023, regjistruar 299 çështje, ky raport paraqitet rreth 64% ($193/299 \cdot 100$). Sa trajtuar dhe në raportimet e periudhës 4- mujore dhe 8-mujore, rishikimi i treguesve është bërë bazuar në faktin e treguesve të realizuar për vitin 2022 si dhe numrin e lartë të dosjeve të mbartura në Prokurorinë e Posaçme, krahasuar me numrin e dosjeve parashikuar për të përfunduar për vitin 2023. Për vitin 2023 janë parashikuar për të përfunduar 190 dosje dhe janë përfunduar 193 dosje me një realizim rreth 102%.

2.Lidhur me produktin 19AA604 blerje autovetura bazuar në buxhetin e miratuar për realizimin e këtij produkti në shumën 10 milion lekë, në përfundim të procedurës është realizuar blerja sipas sasisë së parashikuar në shumën 8 milionë lekë, me një kursim rreth 2 milion lekë.

3.Lidhur me produktin:19AA604 blerje pajisje zyre, nga buxheti i rishikuar në shumën 0.76 milion lekë është realizuar blerja e pajisjeve sipas së sasive të rishikuara në shumën 0.47 milion lekë me një kursim rreth 0.3 milion lekë.

4. Lidhur me produktin: 23AB91 ndërtim muri rrethues për godinën e re të kaluar në administrim të Prokurorisë së Posaçme, parashikuar fondi në shumën 4 milion lekë, për shkak të vonesave në nxjerrjen e lejes së ndërtimit nga AZHT si dhe të rishikimeve në projekt, nuk është arritur të realizohet gjatë vitit 2023, rrjedhimisht nuk janë realizuar as shërbimet e mbikqyrjes së punimeve dhe të kolaudit. Është realizuar vetëm shërbimi i studim projektimit marrë në dorëzim në dhjetor 2023, por për moslëshim të faturës nga operatori brenda 29.12.2023 likujdimi do të kryhet gjatë vitit 2024.

5. Lidhur me produktin: 19AA605 blerje pajisje elektronike, fondi i rishikuar është në shumën 9 milion lekë. Për shkak të terheqjes në datën 27.12.2023 të Operatorit Ekonomik të shpallur fitues, nuk është arritur realizimi i kësaj procedure.

4.3.VEPRIMET VIJUESE NË NIVELIN E PROGRAMIT BUXHETOR

Bazuar në gjetjet e evidentuara nga analiza mbi përdorimin e fondeve buxhetore gjatë vitit 2023, institucionet e SPAK do të angazhohen në periudhën vijuese duke synuar përdorimin me eficiencë dhe efektivitet maksimal të burimeve financiare në funksion të arritjes së qëllimit dhe objektivave të synuara dhe rritjen e nivelit të performancës së treguesve të Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

5.PROJEKTET KAPITALE

Gjatë vitit 2023, Prokuroria e Posaçme është angazhuar në realizimin e disa projekteve të rëndësishme:

1.Projekti “Blerje të pajisjeve dhe sistemeve elektronike për rritjen e sigurisë kibernetike dhe sistemit teknologjik për suportin e hetuesve në terren”. Për Prokurorinë e Posaçme është miratuar një Grant

me vlerë 169.2 milion lekë, me burim nga AAPSK, finalizuar midis palëve me lidhjen e Kontratës protokolluar me nr.1189, datë 30.03.2023, pranë Prokurorisë së Posaçme dhe Nr.206 prot., datë 30.03.2023, pranë AAPSK.

Bazuar në fondet e AAPSK dhe fondet buxhetore, Prokuroria e Posaçme në cilësinë e Autoritetit Kontraktor gjatë vitit 2023, inicioi procedurat e prokurimit me objekt:

- a) Blerje sisteme/pajisje të teknikës operative, procedurë e klasifikuar “sekret” në shumën 101 milion lekë (pa tvsh) (me fondet e AAPSK), procedurë e cila do të realizohet sipas akteve ligjore dhe nënligjore të cilat rregullojnë procedurat e prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, dhe do të vijoj dhe gjatë vitit 2024.
- b) Blerje sisteme dhe pajisje elektronike në shumën 84.5 milion lekë (pa tvsh)(me fondet e AAPSK dhe të buxhetit të shtetit). Lidhur me këtë procedurë e ndarë në 5 lote, në pamundësi të përfundimit me sukses të lotit ku ishte parashikuar anagazhimi i fondeve buxhetore në shumën 37.5 milion lekë, Prokuroria e Posaçme mori masat për deklarimin pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si teprica në zërin e Investimeve për shumën 45 milion lekë(me tvsh). Me Aktin Normativ Nr.6, datë 14.12.2023 është miratuar pakësimi i fondit për investime në shumën 45 milion lekë. Gjatë vitit 2024 do të vijoj realizimi i produkteve sipas projektit të AAPSK-së, procedura të cilat do ti nënshtrohen rregullave të përcaktuara në ligjin 162/2020 “Për Prokurimin Publik”
- c) Projekti për ndertimin e një muri rrethues për godinën e re, në shumën 4 milion lekë, procedurë e cila për shkak të mosmiratimit në kohë të lejes së ndërtimit dhe të rishikimit të projektit (trajtuar dhe më lartë) nuk është arritur të realizohet.

6.NDRYSHIMET NË BUXHET

Referuar ndryshimeve ligjore gjatë vitit 2023, ka patur rishikime të buxhetit konkretisht:

- a) Me VKM Nr. 437, datë 19.07.2023 “Për shtesë fondi në buxhetin e miratuar për vitin 2023 për disa institucione të pavarura të krijuara me ligj”, rrjedhojë e efekteve të Ligjit 33/2023 “Për një ndryshim në ligjin 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, për SPAK janë akorduar fonde në shumën 55 milion lekë.
- b) Me Aktin Normativ Nr. 5 datë 18.10.2023 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023, bazuar në deklaratimet e tepricave dhe kërkesa për shtesa të fondeve buxhetore për SPAK, është miratuar, pakësim i fondeve në shumën 176 milion lekë, nga të cilat për zërin paga dhe sigurime në shumën 158 milion lekë. Deklarimi i tepricave buxhetore ka qënë rrjedhojë e vakancave në dy institucionet e SPAK.
- c) Me VKM Nr.755, datë 20.12.2023 “Për një shtesë fondi në buxhetin e miratuar për vitin 2023, për disa institucione të pavarura”, për SPAK janë akorduar fonde në shumën 60 milion lekë. Qëllimi i akordimit të fondeve nëpërmjet këtij akti ka qënë me qëllim likuidimin e efekteve nga rillogaritja e pagës bazë referuese për magjistratët dhe jo magjistratët, rrjedhojë e zbatimit të Vendimit 35/2022 Gjykatës Kushtetuese, me efekt nga data 01.01.2019. Bazuar në fondin

e pagave të miratuar me ligjin e buxhetit dhe atë të akorduar me aktet e sipërcituara, SPAK ka likuajduar të gjitha detyrimet rrjedhojë e efekteve të Vendimit të GJK, në total rreth 140.8 milion lekë, nga të cilat Prokuroria e Posaçme rreth 72.2 milion lekë dhe BKH në shumën 68.6 milion lekë.

- d) Me Aktin Normativ Nr.6, datë 14.12.2023 është miratuar pakësimi i fondit për investime në shumën 45 milion lekë dhe shtesë fondi shpenzime proceduriale 4 milion lekë.
- e) Me VKM Nr.795, datë 28.12.2023 “Për shpërblimin e punonjësve të qeverisjes qendrore në procesin e shqyrtimit analitik të acquis(screening), në kuadër të procesit të negociatave me bashkimin Evropian” për SPAK është miratuar shtesë fondi në shumën 1.5 milion lekë.

7.PËRFUNDIME

Menaxhimi Financiar i Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar është fokusuar në financimin e shpenzimeve për përmbushjen e objektivave prioritare strategjike të institucionit të cilat konsistojnë kryesisht në:

- 1 Krijimi i të gjitha kapaciteteve të nevojshme për Prokurorët, Hetuesit e BKH dhe personelin administrativ, në funksion të arritjes së rezultateve pozitive në luftën kundër krimin të organizuar dhe korrupsionit.
- 2 Përdorimin e teknologjisë më të avancuar në funksion të ekspertizës dhe hetimeve proaktive sipas kompetencës ligjore të Prokurorisë së Posaçme dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit.
- 3 Përmirësimin e infrastrukturës së nevojshme për kryerjen e proceseve të punës në shërbim të një trajtimi sa më efektiv të rasteve hetimore si dhe të krijimin e kushteve të përshtatshme të punës për punonjësit.